



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.27, datë 30.01.2023

PËR
“CAKTIM TË PËRKOHSHËM”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Zoti Kujtim Basha, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, të caktohet përkohësisht si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
2. Zoti Kujtim Basha do të ushtrojë funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nga data 01.02.2023 - 30.04.2023.
3. Të njoftohen për këtë vendim zoti Kujtim Basha, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 30.01.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Alfred Balla

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Elaida Coxhi

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj


ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Mirela Bogdani



ANËTAR
Arta Mandro



ANËTAR
Ledina Riza

